

# ARSIMIMI E DREJTA JONË BAZË



## UDHËHEQJE EFEKTIVE NGA POPULLI

NAMON (10), ERMIR (10), AMAR C. (10), DION (11), RINESA (10), ERINA (10), DENIZA (10)



**Ekzistojnë disa sisteme të qeverisjes, të cilat janë krijuar nga vetë qytetarët. Por, a e dini ju se cili është sistemi deri më tash i dëshmuar si më efektiv? Për këtë do t'iu njoftojmë ne**

Gjithmonë qytetarët kanë shpresuar se një ditë do të vie koha kur qeverisja do t'iu takojë të gjithëve dhe jo vetëm një personi të caktuar. Dëshmitarë të kësaj kohe jemi edhe ne nxënësit, të cilët tashmë kemi shumë përfitime nga sistemi në bazë të të cilit jetojmë. Ky



sistem për të cilin po flasim është i njohur si demokraci. Vetë kuptimi i fjalës demokraci do të thotë udhëheqje nga populli. Kjo i bie se të gjithë, pa marrë parasysh çfarëdolloj dallimi, kanë të drejtë të jenë pjesë e vendimmarrjes. Ky pra, është sistemi demokratik, i cili iu jep vlerë dhe fuqi secilit qytetar. Kjo vie ngase demokracia brenda vetes përfshin disa elemente që janë mjaft të vlefshme dhe që përmirësojnë jetën e popullit. Disa nga këto elemente janë: liria, barazia,

toleranca, respekti, etj. Që nga shfaqja e demokracisë e deri më tash ka pasur zhvillim të vazhdueshëm të këtyre elementeve. Këtë zhvillim të elementeve të demokracisë e ka bërë vetë populli, përmes punës së tij të pandalshme. Kur themi se populli ka ndikuar në zhvillimin e demokracisë nënkuptojmë qytetarët të cilët janë treguar dhe vazhdojnë të tregohen aktiv. Pa aktivizim të qytetarëve, demokracia si koncept nuk mund të zhvillohet. Andaj, përgjegjësia na takon neve për ta ruajtur dhe për ta mbajtur atë ashtu siç na ka hije. Demokracia ka arritur edhe në shtetin tonë Kosovën në vitin 2008. Që nga ky vit, shihet se ka gjithmonë tendencë që të punohet në ngritjen e nivelit të saj. Kjo vërehet edhe nga vetë interesimi ynë për të mësuar që nga kjo moshë për vlerën dhe rëndësinë e demokracisë. Do të mundohemi gjithnjë të shpërndajmë sa më shumë informata lidhur me të, në mënyrë që të formojmë një shoqëri edhe më demokratike.



**Ne jemi demokratët e vegjël të Kosovës**

## INICIATIVAT TONA SI QYTETARË AKTIV

Në vazhdim do të keni mundësi t'i lexoni disa nga iniciativat që ne kemi ndërmarrë si qytetarë aktiv. Interesimi ynë për t'iu ndihmuar të tjerëve ka filluar që nga koha kur jemi bërë pjesë e sistemit edukativo-arsimor. Ky interesim ka ardhur nga vullneti dhe zemërgjerësia jonë

Jo çdo herë duhet t'i ndihmojmë vetëm vetes sonë. Neve si qenie sociale na takon dhe e kemi përgjegjësi të kujdesemi edhe për të tjerët. Duke u nisur nga ky fakt, ne kemi ndërmarrë disa iniciativa për bashkëmoshatarët tanë. Disa nga iniciativat tona i kemi paraqitur edhe në vizatimet më poshtë. Çfarë kemi bërë ne? Ne kemi mbledhur fonde për fëmijët me probleme shëndetësore, kemi mbledhur lodra për fëmijët të cilët janë jetim, si dhe kemi përgatitur dhurata për fëmijët e varfër. Nga këto veprimtari, ne jemi frymëzuar edhe më shumë që gjithmonë të jemi aktiv. Kështu sigurohet e ardhme e mirë dhe e sigurt për të gjithë. Andaj, me shumë kënaqësi iu ftojmë që të na ndihmoni të promovojmë së bashku sa më shumë qytetarinë aktive.




Dioni duke vizatuar për qytetarinë aktive



Ne gjithmonë ndihmojmë të moshuarit



Dhurata të filla kemi përgatitur për fëmijët e tjerë



Shpërndarja e njohurive bën pjesë në qytetarinë aktive




Jam i lumtur që jam aktiv



## TË VOTOSH ËSHTË KËNAQËSI

AMAR (10), ARLIND (11), JETMIR (10), ELONA (10), ILIRJONA (11), ARLINDA (11)



**Çfarë do të mund të lexoni në këtë artikull? Në këtë artikull do të lexoni për zgjedhjet. Artikullin e kemi shkruar ne fëmijët, prandaj do të jetë më ndryshe se artikujt në gazetatat e tjera**

Në vazhdim unë Amari do t'iu tregoj një shembull nga jeta ime e përditshme. Një ditë shkuam tek gjyshërit e mi për fundjavë. Aty takuam edhe fëmijët e tezeve dhe dajëve të mi. Duke kaluar kohë së bashku, hasëm në një problem. Dëshironim të luanim një lojë, por nuk dinim çfarë të luanim. Prandaj, ne u ulëm dhe filluam të mendonim. Më vonë, mua mu kujtua të luajmë votimesh. Këtë ide ua propozova të tjerëve. Atyre u pëlqeu ideja ime dhe të gjithë pranuan. Kështu ne morëm disa fleta të bardha dhe në to shënuam kandidatët e mundshëm. Këta kandidatë ishin disa nga fëmijët, të cilët ishin të pranishëm. Dikush nga radhët tona do të na përfaqësonte neve. Pikërisht si në demokraci. Prej kandidatëve të shënuar ne duhet ta zgjedhim vetëm njërin. Sipas mendimit tonë, ai/ajo do të ishte kandidati më i mirë. Emrit të kandidatit, i cili na pëlqente më së shumti i vendosim një shenjë „tick“. Pas votimit, ne numëruam votat. Dy nga kandidatët më të mirë kishin marrë numër të barabartë të votave. Andaj, ne do të votonim prapë. Kjo quhet balotazh. Kësaj here ne do të votonim vetëm njërin nga këta dy kandidatët e mbetur. Në fund, sigurisht se fitoi kandidati më i mirë. Në të njëjtën mënyrë funksionojnë edhe zgjedhjet shtetërore. Në zgjedhjet lokale apo komunale populli zgjedh kryetarët e komunave përkatëse, ku secili qytetar voton për komunën e tij/saj.

Ndërsa, në zgjedhjet parlamentare apo qendrore, të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht komunës ku jetojnë mund të shprehin mendimin e tyre për kandidatin e preferuar për deputet. Si rezultat, nga zgjedhjet parlamentare përzgjedhen gjithsej 120 deputetë, të cilët do të punojnë në Parlamentin (Kuvendin) e Kosovës. Të drejtën e zgjedhjes e gëzojnë të gjithë qytetarët nga moshë 18 e tutje.

Kur ishim dje në shkollë, vendosëm të luanim një lojë. U mbledhëm të gjithë nxënësit të diskutonim cilën lojë ta luanim. Por, ne kishim mendime të ndryshme. Disa nga ne donim të luanim kukafshehtas, disa futboll, disa delfin e disa të tjerë lojëra të tjera.

Pasi që jetojmë në demokraci, vendosëm të votojmë. Loja që mori vota më shumë ishte loja delfin. Kështu të gjithë së bashku u argëtuam duke luajtur këtë lojë. Këta pra, janë vetëm disa shembuj se si ne, edhe pse nuk jemi akoma të rritur, mund të votojmë. Kurse, në zgjedhjet e para që do të mbahen pasi të arrijmë moshën 18 vjeçare, ne premtojmë se do të votojmë!



Fytyrat dhe mendjet e përkushtuara të gazetarëve

## FUNKSIONI LEGJISLATIV I KUVENDIT

ELMEDINA (10), ADISON (11), ALMIRA (10), AMAR (10), YLLKA (10), ERION (10)



### Ligjet na ndihmojnë të kemi një jetë të rregullt dhe me veprime pozitive

E si do të ishte fillimi i një viti të ri më i mirë se me pjesëmarrjen tonë në Punëtorinë për Demokraci „Demos-ti“? Brenda kësaj Punëtorie, ne kemi zhvilluar aktivitete të ndryshme, kemi mësuar për demokracinë dhe më pas jemi ndarë në grupe të vogla. Në grupin tonë, ne kemi diskutuar për institucionin më të lartë në shtetin e Kosovës, i cili është Kuvendi ynë.

Në klasën tonë, çdo vit e zgjedhim kryesinë e klasës. Kryesia e klasës brenda vetes ka kryetarin e klasës, sekretarin, arkatarin, si dhe përgjegjës të detyrave. Të gjithë këta persona, ne i zgjedhim me anë të votave. Ngjashëm ndodh edhe me institucionin për të cilin diskutuam në grupin e vogël, pra, me Kuvendin. Përfaqësuesit e Kosovës të cilët zgjedhen me anë të votave të qytetarëve quhen deputetë dhe gjithsej janë 120. Këta 120 deputetë, të cilët punojnë në Kuvend, kanë detyra të shumta. Ata zgjedhin Kryetarin e Kuvendit, zgjedhin Kryeministrin, Presidentin, etj. Por, ata kanë për detyrë ta bëjnë edhe miratimin apo mos miratimin e ligjeve të propozuara. E dini ju se çka janë ligjet? Ligjet janë rregulla të shkruara, të cilat duhet të respektohen dhe të zbatohen nga të gjithë qytetarët e Kosovës, pa asnjë dallim.

Ligjet janë shumë të rëndësishme për ne, sepse po të mos kishte ligje, jeta jonë do të ishte plotësisht e çrregulluar. Pa ligje, do të kishte mundësi të paraqitej

dhuna fizike ndërmjet qytetarëve, ata do të hedhnin mbeturina në rrugë, apo nxënësit nuk do të shkonin në shkollë.

Ne kemi një sugjerim për një ligj tjetër. Ne mendojmë që duhet të ekzistojë një ligj, i cili do ta ndalonte rreptësisht pirjen e duhanit dhe shitblerjen e tij. Pra, ne do të dëshironim që konsumimi i duhanit të ilegalizohet. Me këtë ligj, ne si qytetarë do të jemi më të shëndetshëm dhe ajri do të jetë më i pastër.

Ne e vlerësojmë shumë ekzistencën e ligjeve, por gjithashtu i respektojmë dhe i zbatojmë ato. Kur shkojmë në shkollë, ne e kalojmë rrugën tek vendkalimi për kombësorët dhe kjo dëshmon se ne jemi qytetarë të rregullt. Duam që të gjithë qytetarët të vetëdijësohen dhe t'i respektojnë institucionet e shtetit, gjegjësisht ligjet që dalin nga Kuvendi. Me respektim të ligjeve, Kosova do të zhvillohet shumë më shumë.



Viti 2018, në Punëtorinë „Demos-ti“ na bëri gazetarë





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Zenel Hajdini“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë